



Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

Viti shkollor 2016/2017

TESTI

MATEMATIKË

UDHËZIME PËR PUNË

- Testin të cilin duhet të zgjidhësh i ka **20 detyra**. Për zgjidhjen e detyrave janë paraparë **120 minuta**.
- Detyrat nuk domethënë se duhet t'i zgjidhësh sipas radhitjes që janë dhënë.
- Ki kujdes se detyrat dallohen sipas mënyrës se si duhet të japësh përgjigje, (duke e plotësuar përgjigjen, duke e rrethuar, duke e bashkuar dhe duke e nënvizuar e të tjera).
- Gjatë punës mund të përdorësh lapsin e thjeshtë, gomën, vizoren, trekëndëshin dhe kompasin, por jo edhe kalkulatorin.
- Përgjigjet definitive dhe procedurën shkruaje me **stilolaps**.
- Përgjigjja e cila është shkruar vetëm me laps të thjeshtë nuk do të pranohet, si edhe përgjigjja të cilës i është hequr vizë.
- Mos shkruaj asgjë në këtë dhe në faqen e fundit, as në katrorin i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës.
- Nëse e mbaron më herët zgjidhjen e testit, dorëzoje testin dhe largohu ngadalë duke pasur kujdes për qetësi.

Ju dëshirojmë sukses në test!

1. Në tabelë janë paraqitur të dhënat mbi lartësinë e trashësisë së dëborës në male gjatë një dite dimri.

Malet	Lartësia e trashësisë së dëborës (në metra)
Kopaoniku	0,43
Tara	0,4
Zllatibori	0,39
Goça	0,06
Stara planina	0,6
Zllatara	0,1
Mali i Sharrit	0,65

- a) Në cilin mal lartësia e trashësisë së dëborës është më e vogël?

Lartësia e trashësisë së dëborës është më e vogël në _____.

- b) Në cilin mal lartësia e trashësisë së dëborës është më e madhe?

Lartësia e trashësisë së dëborës është më e madhe në _____.


2. Në fotografi është paraqitur çmimorja e furrës „Kokërra e mirë”. Çfarë vlere ka paguar Gëzimi, nëse në këtë furrë ka blerë dy pogaçe dhe 200 g pite me mish?

Kokërra e mirë

Kifla e thjeshtë.....	20 din.
Kifla integrale.....	25 din.
Pogaça.....	30 din.
Gjevreku i thjeshtë.....	30 din.
Gjevreku i zier.....	33 din.
Kroasan.....	35 din.
Bukë misri.....	43 din.
Pite me djath/100g.....	60 din.
Pite me mish/100g.....	70 din.

Gëzimi ka paguar në vlerë prej _____ dinarë.

3. Në figurë është paraqitur drejtëkëndëshi $ABCD$. Njehso vlerat e të panjohurave x dhe y .
Trego ecurtinë.



$$x = \underline{\hspace{2cm}}; \quad y = \underline{\hspace{2cm}}$$

4. Shëno në fushën e zbrazët numrin përkatës, ashtu që barazimi të jetë i saktë.

$$3^2 \cdot (3^5)^4 = 3^{\bigcirc}$$

5. Mundja është sport olimpike. Lufta zhvillohet në dyshekun i formës rrethore, rrezja e të cilës është 5 m. Cakto sipërfaqen e dyshekut në të cilën zhvillohet lufta.

Sipërfaqja e dyshekut është $\underline{\hspace{2cm}}$ m².

6. Njehso sipërfaqen dhe vëllimin e kubit, nëse gjatësia e tehut të tij është 10 cm.
Trego ecurtinë.


$$S = \underline{\hspace{2cm}} \text{ cm}^2; \quad V = \underline{\hspace{2cm}} \text{ cm}^3$$

7. Në parlamentin e nxënësve mësuesja ka pyetur Benjaminin sa nxënës ka në klasën e shtatë e sa ka nxënës në klasën e tetë. Benjamini numrin e nxënësve e ka rrumbullakuar në dhjetëshen më të afërt dhe është përgjigjur: „Në klasën e shtatë janë 70 nxënës, kurse në klasën e tetë janë 80 nxënës.” Njëri nga pohimet e dhënë është i saktë. Cili është ky pohim?

Rretho shkronjën para pohimit të saktë.

- a) Në klasën e shtatë janë 64 nxënës.
 b) Në klasën e shtatë janë 74 nxënës.
 c) Në klasën e tetë janë 74 nxënës.
 d) Në klasën e tetë janë 86 nxënës.

8. Në sistemin koordinativ janë paraqitur kontinentet.




- a) Pika me koordinatat (5, 4) i takon Europës?

Pika me koordinatat (5, 4) _____ Europës.
 (i takon/nuk i takon)

- b) Cakto numrin natyror a ashtu që pika me koordinatat (9, a) i takon Australisë.

$a =$ _____

9. Egzistojnë katër grupe të gjakut (O, A, B, AB) prej të cilave çdo njëra mund të jetë pozitive ose negative. Në diagram është paraqitur përfshirja e grupeve të gjakut, të një qyteti.



- a) Sa është përqindja e banorëve që kanë grupin e gjakut A⁺?

_____ % banorë


- b) Rretho dy grupe gjaku, të cilat janë të përfshira në mënyrë të barabartë në mesin e banorëve të atij qyteti.

O⁻ O⁺ A⁻ A⁺ B⁻ B⁺ AB⁻ AB⁺

- c) Sa është përqindja e përgjithëshme e banorëve që kanë grupin e gjakut AB?

_____ % banorë

10. Benjamini në një letër shënoi numrin pesëshifror, por një pjesë të letres e ka grisur dhe kanë mbetur vetëm katër shifrat e para, të dukshme, e ato janë 5432. Cila është shifra e fundit, e numrit pesëshifror, të cilën Benjamini e ka shënuar, nëse dihet se numri është i plotëpjesëtueshëm me numrin 9? Rretho shifrën e cila mungon.



0 1 2 3 4 5 6 7 8 9


11. Thjeshtëso shprehjen.

Trego ecurtinë.

a) $3 \cdot (2x - 5) - 2 \cdot (3x + 4) =$ _____

b) $(2a + 5) \cdot (a - 3) =$ _____


- 12.** Masa e përgjithshme e 20 qeseve të çajit prej kamomili është 25 gram. Sa është masa e tri qeseve të atij çaji? Trego ecurtinë.



Masa e tri qeseve të atij çaji është _____ gram.

- 13.** Katërkëndëshi $ABCD$ në fotografi është kënddrejti. Cakto shumën e gjatësive të segmenteve AM dhe MN .

Trego ecurtinë.



$AM + MN =$ _____ cm

- 14.** Nxënësit kishin për detyrë të shkruanin numrin 2017 dhe ta rifotografonin sipas simetrisë boshtore duke shfrytëzuar programin për përpunimin e tekstit. Mësuesja ka treguar fotografi të cilat i kanë punuar. Rretho fotografinë në të cilën është paraqitur zgjidhja e saktë.

2017 | 2017

2017 | 7107

2017 | 5017

2017 | 7107

- 15.** Në garat shkollore nga matematika kanë marrë pjesë 9 nxënës të klasës së tetë. Rezultatet janë paraqitur në tabelë. Në garat komunale janë kualifikuar nxënësit të cilët kanë pasur më shumë se 60 poenë. Cakto numrin mesatar të poenave të nxënësve të cilët janë kualifikuar në garat komunale. Trego ecurtinë.

Numri i poenave	Numri i nxënësve
25	2
45	1
70	2
75	1
80	1
85	1
100	1

Numri mesatar i poenave të nxënësve të cilët janë kualifikuar në garat komunale është _____.

- 16.** Z. Benjamini udhëton me autobus në Nish me gruan dhe dy fëmijë. Buleta për personat e rritur kushton 1 080 dinarë, kurse për fëmijë kushton 900 dinarë. Për blerjen e biletave të autobusit z. Benjamini shfrytëzon „Kartelën për zbritje” të paraqitur në fotografi. Cakto sa duhet të paguajë z. Benjamini biletat e autobusit, nëse i blen duke shfrytëzuar kartelën.

Trego ecurtinë.

Kartela për zbritje

Buleta për të rritur – zbritja 20%

Buleta për fëmijë – zbritja 25%

Z. Benjamini biletat e autobusit duhet t'i paguajë _____ dinarë.

17. Njehso vlerën e shprehjes.

Trego ecurtinë.

$$\frac{\sqrt{0,4 \cdot 1,6} + \sqrt{5,76 : 4}}{\frac{2}{5}} - 5 \cdot \left(\sqrt{\left(1 + \frac{7}{9}\right)^2} - \sqrt{\left(1 - \frac{2}{9}\right)^2} \right)$$

Vlera e shprehjes është _____.



18. Janë dhënë shprehjet: $A = x - 3$ dhe $B = (x - 2) \cdot (3x + 1)$.

Cakto të gjithë numrat natyrorë x për të cilët shprehja është $3A^2 - B$ pozitive.


Trego ecurtinë.

$$x \in \{ \underline{\hspace{2cm}} \}$$



19. Cakto vlerën e këndit x , të paraqitur në fotografi, nëse drejtëza AB është paralele me drejtëzën DE .

Trego ecurtinë.



$$x = \underline{\hspace{2cm}}$$



- 20.** Diagonalja e faqes anësore të prizmit të rregullt gjashtëfaqësh me tehun e bazës ndërton këndin prej 30° . Cakto vëllimin e këtij prizmi, nëse tehu i bazës është me gjatësi 6 cm.

Trego ecurtinë.

$$V = \underline{\hspace{2cm}} \text{ cm}^3$$

